



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER  
NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Fier, më \_\_\_\_\_ 06.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pajisje elektronike dhe mobilje për Qendrën Multifunkionale për të Rinjtë, Fier” me 2 lote**

**Loti 1: “Blerje pajisje elektronike për Qendrën Multifunkionale për të Rinjtë, Fier”**

**Loti 2: “Blerje mobilje për Qendrën Multifunkionale për të Rinjtë, Fier”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Kompjuter desktop 30213300-8

Televizor me ngjyra 32324100-1

Karrige 39112000-0

Tavolina kompjuteri 39134100-1

Rafte 39141100-3

**VLERA E FONDIT LIMIT:** prej **3 610 330.96** (tre milion e gjashtëqind e dhjetë mijë e treqind e tridhjetë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe prej **4 332 397.16** (kater milion e gjashtëqind e dhjetë mijë e treqind e tridhjetë pike nëntëdhjetë e gjashtë) lekë me TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit dhe i Bashkisë Fier.

**Loti 1: Blerje pajisje elektronike për Qendrën Multifunkionale për të Rinjtë, Fier – 3 119 914.30** (tre milion e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë pike tridhjetë) lekë pa TVSH

**Loti 2: Blerje mobilje për Qendrën Multifunkionale për të Rinjtë, Fier – 490 416.66** (katërqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **Loti 1: Blerje pajisje elektronike për Qendrën Multifunktionale për të Rinjtë, Fier**

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, ne te cilen eshte e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 8*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2022, 2023**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak se **1 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet-per Lotin 1). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te ligjit nr. 162/2020 ”Per Prokurimin Publik”i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe

*financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepërmjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomikë dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkojë në Procedurën e Hapur e thjeshtuar, përkatësisht; Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;* Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

---

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e dy viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të parashikuar.*

---

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se **600 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet -per Lotin 1), që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

**a-** vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**ose**

**b-** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo me pak se **600 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet -per Lotin 1) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, piken 4 te nenit 40 dhe piken 4/b te nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e ketij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine teknike te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet pervojese se meparshme, se zoterojne kapacitetet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet te paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori per zerat e mallrave sipas tabelës se meposhtme. Ne rast se do te

paraqitet autorizim distributori duhet te provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Secili nga dokumentat duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet te jete i vlefshem ne momentin e hapjes dhe dorëzimit te ofertave si dhe origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara.

**Tabela me zerat e mallrave per te cilat duhet te paraqiten autorizim prodhuesi ose autorizim distributori:**

Nr.	Emertimi i mallrave
1.	Kompjuter Desktop
2.	Laptop
3.	FV TV Led Smart (4K,65’')
5.	FV TV Led (8K,85’')

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku eshte e cituar: 5. *Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Duke iu referuar per analogji vendimeve te KPP-se dhe rekomandimeve te APP-se, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar qe te paraqitet autorizim prodhuesi ose autorizim distributori per disa mallra objekt prokurimi sipas tabelës per shkak te peshës specifike qe zene ne preventivin e mallrave.

Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos ne mbështetje te Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik”.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshurë, per zerat e mallrave sipas tabelës se mëposhtme, nga prodhuesi (*sipas autorizimit te prodhuesit ose distributorit të autorizuar*) ku të jene te percaktuar zerat e mallrave dhe specififikimet teknike të tyre (*të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara*). Në katalogë/broshura duhet te markohen (*per lehtësi identifikimi*) artikujt dhe specififikimet teknike sipas atyre të përcaktuara ne DST.

**Tabela me zerat e mallrave per te cilat duhet te paraqiten katalogë/broshurë :**

Nr.	Emertimi i mallrave
1.	Kompjuter Desktop

2.	Laptop
3.	FV TV Led Smart (4K,65’')
5.	FV TV Led (8K,85’')

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 4 pika 38/b, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik i ndryshuar, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne të cilën është e përcaktuar se:[...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

Duke iu referuar për analogji vendimeve të KPP-se dhe rekomandimeve të APP-se, Autoriteti Kontraktor ka gjuar që të paraqitet katalogje/ broshure për disa mallra objekt prokurimi sipas tabelës për shkak të peshës specifike dhe rendesise së tyre që zënë në preventivin e mallrave. Paraqitja e katalogjeve për disa zera mallrash, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallrave që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetedeklarim ku merr për sipër instalimin dhe konfigurimin e mallrave objekt prokurimi sipas nevojës të Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të pikës 6 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësive) ose ekuivalent, e vlefshme, për objektin që prokurohet (të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara), të lëshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohura në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që autoriteti kontraktor të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të përmbushur me sukses kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikatën e menaxhimit të cilësive që parashikohet nga legjislativi në fuqi për mallrat objekt i prokurimit, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Certifikata per menaxhimin e cilesise ISO 9001 eshte referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithë sektoreve dhe te gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e mallrave dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

.....

## **Loti 2: Blerje mobilje për Qendrën Multifunktionale për të Rinjtë, Fier**

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, ne te cilen eshte e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 8

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2022, 2023**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak se **150 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet -per Lotin 2). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga

secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;* në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku percaktohet se: Pika 1. *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.* Pika 2/c: *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur e thjeshtuar, perkatesisht; Pika 2/c: *2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;* Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të percaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

---

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku percaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku percaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka



gjykuar te nevojshme percaktimin e dy viteve te fundit ne perputhje me vleren e fondit limit te parashikuar.

---

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se **80 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet-per Lotin 2), që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese një nga dokumentat e meposhtem:

**a-** vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**ose**

**b-** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, te plotësuara sipas kërkesave te legjislacionit ne fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo me pak se **80 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet -per Lotin 2) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, piken 4 te nenit 40 dhe piken 4/b te nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e ketij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine teknike te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet pervojese se meparshme, se zoterojne kapacitet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:katalogë / broshura / foto ilustruese ose cdo lloj dokumentacioni tjetër teknik, për pajisjet e kërkuara duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga pajisjet e ofruara me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse pajisjet e ofruara janë sipas specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit. Fleta ose fletët e katalogut/broshurës për pajisjet duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, dhe nese jane ne gjuhe te huaj të jene te përkthyer dhe te noterizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 4 pika 38/b, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik i ndryshuar, si dhe me piken 6/b te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se:[...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*

Duke iu referuar per analogji vendimeve te KPP-se dhe rekomandimeve te APP-se, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar qe te paraqitet katalogje/ broshure mallra objekt prokurimi sipas tabelës për shkak të rëndësise se tyre Paraqitja e katalogjeve është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmerise se mallrave qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST.

2.3.3 Në rastin kur OE nuk është prodhues i këtyre produkteve artikujve ,OE duhet të paraqesin autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për mallrat e kërkuara objekt prokurimi. Ne rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet të provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar. Secili nga dokumentat duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave si dhe origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është bazuar ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku eshte e cituar: 5. *Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Duke iu referuar per analogji vendimeve te KPP-se dhe rekomandimeve te APP-se, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar qe te paraqitet autorizim prodhuesi ose autorizim distributori.

Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik”.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ofrojë garanci 2(dy) vjecare për mallrat e ofruar nga momenti i marrjes në dorëzim, si dhe ndërrimin në raste defektesh nëpërmjet një deklarate për periudhën e garancisë, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë edhe riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent, e vlefshme, për objektin që prokurohet (të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara), të lëshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Nderkombëtare Akreditues të njohura në Republikën e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që autoriteti kontraktor të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të përmbushur me sukses kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikatën e menaxhimit të cilësisë që parashikohet nga legjislati në fuqi për mallrat objekt i prokurimit, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Certifikata për menaxhimin e cilësisë ISO 9001 është referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e mallrave dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

**Shënim:** Operatorët ekonomikë të cilet do të paraqesin ofertat/ konkurrojnë për me shumë se një lot, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta, xhiron vjetore sipas pikës 2.2.2., dhe përvojën e ngjashme sipas pikës 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar dhe argumentuar nga specialistet e fushës dërguar me shkresën nr.6271 prot date 06.06.2024 të Drejtorisë së Projekteve të Infrastruktura për të dyja lotet (bashkëngjitur DST në SPE), si dhe në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të

ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar. Kriteret teknike te vecanta te kualifikimit lidhur me kapacitetin teknik jane hartuar e argumentuar nga specialisti i fushes perkates per lotin perkates.

**Bashkalidhur DST në SPE.**

*Specifikimet teknike nuk kane asnje kerkese apo reference te ndonje marke apo emri te vecante, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, pervec kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme e saktë ose e kuptueshme e pershkrimit te kerkesave me kusht qe fjala “ose ekuivalent” perfshihet detyrimisht ne keto specifikime.*

**Shenim :** *Ne cdo rast kur ne specifikimet teknike dhe preventive mund te jete perdorur si reference emri i ndonje marke apo emri te vecante, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik , perfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.*

**Njësia e Prokurimit:**